



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BUXHETI DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. 1283/Prot.

Tiranë, më 26. 2. 2021

RAPORT

“PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË MINISTRISË SË
ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË PËR VITIN 2020”

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2020, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, në përmbushje të misionit dhe funksionimit të strukturave në varësi të saj, ka vazhduar të rrisë performancën e punës së saj, me qëllimin realizimin me sukses të objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013–2020, detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asocimit me BE, si dhe detyrime të tjera sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, realizimi i të cilave mbështetet tërësisht në Programin Buxhetor Afatmesëm 2020 -2022.

A) MJEDISI I KONTROLLIT

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Menaxherët e nivelit të lartë të njësive publike, shprehin dhe demonstrojnë rëndësinë e integritetit dhe vlerave etike në të gjithë njësinë.

Për të garantuar një menaxhim financiar dhe kontrolli në përputhje me legjislacionin përkatës, kërkesat e buxhetit si dhe parimet e menaxhimit financiar, me transparencë, efektivitet, efikasitet dhe ekonomi, në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë janë krijuar tashmë sistemet e kontrollit të brendshme, të cilat janë gjithmonë në përmirësim duke synuar drejt përmbushjes optimale të objektivave.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 78, datë 08.05.2006, “Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSBI”, i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm) në çdo njësi të qeverisjes qendrore.

Përgatitja e kërkesave buxhetore afatmesme 2021 – 2023, është realizuar mbështetur në Vendimin nr.11 datë 11.01.2016 të KM “Për miratimin e strategjisë së arsimit parauniversitar”, Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”, si dhe strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2013-2020, Udhëzimin nr.7, datë 28.2.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe Vendimit nr. 577, datë 22.07.2020 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023”, si dhe Udhëzimit Plotësues, nr. 28, datë 10.7.2020 “Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023”.

Me Urdhrin nr. 222, datë 12.04.2019 të Ministri i Arsimit Sportit dhe Rinisë “Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (GMS)”, është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, ASCAP, si dhe Agjencia e Shërbimit Kombëtar për Rininë, etj.

Me Urdhrin nr. 222/1, datë 12.04.2019 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë “Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2020-2022”, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, ASCAP, Agjencia e Shërbimit Kombëtar për Rininë, etj.

Të gjithë drejtuesit titullarët, drejtues të nivelit të mesëm apo të ulët në njësi, megjithëse ka qënë një situata mjaft e vështirë me COVID-2019, kanë përfutur trajnime afatshkurtra më qëllim që të janë të vetëdijshëm në lidhje me sistemin e menaxhimit financiar edhe kontrollit të brendshëm MFK-së, jo vetëm specialistët me qëllimi që të sigurojë:

- a) drejtimin e operacioneve në mënyrë të rregullt, etike, ekonomike, efikase dhe efektive;
- b) përfaqshjen e operacioneve me ligjet, rregulloret, politikat, planet dhe procedurat;
- c) ruajtjen e aktiveve dhe burimeve të tjera kundrejt humbjeve të shkaktuara nga keqadministrimi, shpenzime dhe përdorime të panevojshme, si dhe kundrejt parregullsive dhe mashtrimit;
- d) forcimin e përgjegjësisë menaxheriale për një arritje të suksesshme të objektivave të vendosura;
- e) raportimin financiar në kohë dhe monitorimin e rezultateve të performancës.

Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i sistemeve efikase të MFK-së do të ndihmojë në përshtatjen më të lehtë të njësisë ndaj ndryshimeve me të cilat ajo do të përballet në mjedisin e jashtëm apo të brendshëm. **Ministria e Arsimit Sporti dhe Rinisë për vitin 2020**, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas gjashtë programeve të miratuara, të listuar me poshtë:

1. Programi "Planifikim, menaxhim dhe administrim"
2. Programi "Arsimi Bazë"
3. Programi "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm"
4. Programi "Arsimi i Lartë"
5. Programi "Kërkimi shkencor".
6. Programi "Për sportin dhe Rininë".

Për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë është hartuar misioni, në gjashtë programet buxhetore të janë hartuar deklaratat e politikës së programit objektivat kryesore për sigurimin e një menaxhimi eficient dhe efektiv të burimeve njerëzore dhe financiare për periudhën 2020-2022.

Analiza e detajuar e fondeve për periudhën afatmesme 2020-2022, si dhe hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2021-2023, sipas objektivave të përcaktuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 74, datë 27.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, në Udhëzimi Plotësues, nr. 28, datë 10.7.2020 "Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023", si dhe tavanet e miratuara me **Vendimit nr. 577, datë 22.7.2020** të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023".

- **Faza e Parë, përgatitore** "Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", **nuk është realizuar për shkak të situatë COVID-19, Aktin Normativ nr.17, date 22.04.2020**.

- **Faza e Dytë Maj- Shtator 2020**. Shkresa e MASR dërguar ne MFE nr. 4117/1, datë 01.09.2020 hartuar sipas standardeve të Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

- Shkresa e MASR nr. 3085, datë 08.09.2020 dërguar ne MFE "Për përditësimin e përdoruesve të të dhënave në sistemin AFMIS të MFE"

- Kërkesat "**Shtese për Fonde 2021-2023**", **Faza e Dytë**, Maj- Shtator 2020 të vitit financiar, nga MASR është dërguar shkresa e ne MFE nr. 4117/2, datë 14.9.2020.;

<http://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2020/10/Shkrese-2-MFE-Kerkesat-shtese-per-buxhetin-2021-PBA-2021-2023-dt-nr.-4117-2-dt-14.9.2020.pdf>;

Shkresa e MASR nr. 3085, datë 08.09.2020 dërguar ne MFE "Për përditësimin e përdoruesve të të dhënave në sistemin AFMIS të MFE".

- **Faza e Tretë** nga MASR dërguar ne MFE nr. 6818/1, datë 29.12.2020. "Mbi përditësimin e të dhënave në sistemin AMFIS për fazën e tretë të PBA 2021-2023, si dhe detajimin e fondeve të miratuara për vitet 2021-2023", mbështetur në taveve buxhetore të miratuara me ligjin Vjetor të buxhetit nr.137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", si Udhëzim nr. 9, datë 20.3.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar. Të gjitha informacionet tabelat standarde të PBA gjenden të botuara në faqen zyrtare të MASR:

http://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2020/10/08_2020-Relacion_Tavanet_PBA_2021-2023-Final_FN-dt-01.09.2020-FN.pdf

Gjatë vitit 2020 një nga problemet kryesore në kuadër të konsolidimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm ka qenë konsolidimi i strukturave, në mënyrë që ato të sigurojnë se detyrat, hierarkia, linjat e raportimit dhe përcaktimi i aktiviteteve të kontrollit janë ndarë siç duhet në mënyrë që të sigurohet përmbushja e objektivave afatgjatë.

Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Urdhrit të Ministrit nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore rishikuar strukturat sipas Vendimit nr. 505, datë 13.9.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë", si dhe të Urdhrit të **Kryeministrit nr.163, datë 15.10.2017** të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë", strukturë e cila është implementuar brenda 2017.

Për institucionet e sistemit arsimor detyrat delegohen sipas kërkesave ligjore.

- Vendimi nr. 98, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)", ristrukturimin e ish-Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe ish-Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit (ISHA).
- Vendimin nr. 99, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", janë ristrukturuar 13 DAR dhe 25 ZA-ve, duke u krijuar 51 Zyra Arsimore Vendore, 4 Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Tiranë.
- Urdhër nr. 234, datë 19.4.2019 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar".
- Vendim nr.109, datë 15.2.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë".

Parimi 2 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Organi mbikëqyrës (Titullari / Nëpunësi Autorizues / Bordi apo Këshilli i drejtuesve në varësi të llojit të njësisë) demonstroi pavarësi në ushtrimin e detyrave dhe ushtron mbikëqyrje për zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm. Për vitin 2020, në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve (PPAP) të vitit 2020, (miratuar me VKM nr. 837, datë 24.12.2019, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020", të ndryshuar, është parashikuar miratimi i 26 akteve ligjore dhe nënligjore. *(bashkëlidhur matrica me aktet ligjore dhe nënligjore, udhëzime si dhe urdhëra të hartuara dhe miratuara për vitin 2020)*

1. Gjithsej për vitin 2020 janë miratuar 33 (tridhjetë e tre) akte **VKM**. Nga këto 26 akte të parashikuara në PPAP, janë miratuar 15 (pesëmbëdhjetë), si dhe akte **18 (tetëmbëdhjetë)**, të paplanifikuara në PPAP, që janë miratuar në vitin 2020.
2. Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR-së, 27 (njëzet e shtatë) **udhëzime** të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
3. Janë hartuar dhe miratuar nga titullarët e MASR-së rreth **411 (katërqind e njëmbëdhjetë)**, urdhra të brendshëm me karakter të ndryshëm, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe 2 (dy) urdhra të përbashkët.
4. Është dhënë mendim për rreth 83 (tetëdhjetë e tre) projekt-akte të ardhura për mendim nga ministritë e linjës.
5. Gjatë vitit 2020, janë realizuar raporte monitorimi për institucionet publike dhe private të arsimit të lartë "Zbatimi i ligjshmërisë në institucionet e arsimit të lartë në shërbim të sigurimit të cilësisë dhe sigurimit të standardeve përmes shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të tij në institucion", raporte monitorimi për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore për certifikimin e kuotave për programet e studimit. Për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit me karakter profesional dhe programeve të cikleve të studimit për vitin akademik 2020-2021. Mbështetur në udhëzimin nr.1, datë 14.1.2020 të MASR "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", gjatë vitit 2020 janë shqyrtuar **216 aplikime**:

- a Programet me karakter profesional – 40 aplikime

- b Programe bachelor – 46 aplikime
- c Programet master profesional – 32 aplikime
- d Programet master i shkencave – 40 aplikime (16 PIND, ndersa 4 programe papërcaktuar MP apo MSH)
- e Cikli i trete – 58 aplikime gjithsej – 11 Master ekzekutiv, 2 Specializim Afatgjatë, 45 Doktoratë.

Janë miratuar në fazën e parë **68** programe studimi:

- 15 programe me karakter profesional (hapje programe te reja)
- 18 programe “Bachelor”, 10 hapje programi dhe 8 riorganizime
- 5 programe “Master profesional” (3 hapje dhe 2 riorganizime)
- 5 programe “Master i shkencave” (3 hapje dhe 2 riorganizime)
- 16 programe te integruar master i shkencave (15 riorganizime dhe 1 hapje)
- 5 programe “Doktoratë” (4 riorganizim programe ekzistuese dhe 1 hapje program i ri)
- 3 programe “Master Ekzekutiv” (hapje)
- 1 Specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë (riorganizim)

Pas dërgimit të dokumentacionit dhe plotësimeve të kërkuar nga MASR, vijoi procesi për vlerësimin e tyre nga ekspertët e jashtëm të miratuar nga lista vjetore 2020 e Bordit të Akreditimit të ASCAL. Në përfundim te procesit, janë hartuar urdhrat dhe janë miratuar nga MASR programet e studimit per vitin akademik 2020-2021 si më poshtë:

- 13 programe me karakter profesional (hapje programe te reja)
- 17 programe “Bachelor”, 10 hapje programi (4 riaplikim nga 2019) dhe 7 riorganizime.
- 3 programe “Master profesional” (1 hapje dhe 2 riorganizime)
- 3 programe “Master i shkencave” (1 hapje dhe 2 riorganizime)
- 16 programe te integruar master i shkencave (15 riorganizime dhe 1 hapje)
- 2 programe “Master Ekzekutiv” (hapje)
- 1 Specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë (riorganizim)

Ndërsa 5 programe doktoratë (4 riorganizim programe ekzistuese dhe 1 hapje program i ri) bazuar dhe në rivlerësimin e ekspertëve janë refuzuar.

6. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), gjatë vitit 2020 ka realizuar vlerësimin institucional në 5 akreditime institucionale , si dhe 2 Akreditime institucionale të pjeshme, në total jane realizuar 89 procese vlerësimi të jashtëm në kuadër te akreditimit.
7. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), gjatë vitit 2020 ka realizuar ne total akreditim të **89** të programeve te studimit, nga te cilat 9 programe dy vjecare me karakter profesional, **29** programeve të studimit të ciklit të parë “Bachelor”, **31** programe të ciklit të dytë master profesional, 12 programe të ciklit të dytë Master i shkencave i integruar
8. Në bashkëpunim me DAP janë realizuar procedurat për shpalljen e publikimeve për plotësimin e nevojave të institucionit për **25 vende vakante për vitin 2020**, për nëpunësit civilë të MASR; ndjekja e të gjithë procesit të shpalljes së vendeve vakante në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, marrja e masave dhe kryerja e praktikave për caktimin e punonjësve të MASR në Komisionet e përzgjedhjes së kandidatëve, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;
9. Ndjekja e procesit të konfirmimit të **5 punonjësve të MASR**, si nëpunës civilë, pas përfundimit të periudhës 1-vjeçare të provës në shërbimin civil;
10. Në bashkëpunim me institucionet e varësisë janë realizuar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës **për 242 aplikantë dhe pas përfundimit të praktikës 3 mujore janë punësuar 14 praktikantë në aparatit e ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë**, 2 praktikantë pranë Shërbimit Kombëtar për Rininë (Agjencia Kombëtare e Rinisë) dhe 1 praktikant pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
11. Zhvillimi i 21 procedurave të konkurrimit për drejtuesit e ZVAP (zhvillimi i testimit dhe intervistës);
12. Ndjekja e grafikut të trajnimeve pranë ASPA-s, **për 16 punonjës të MASR-së dhe institucioneve të varësisë** si dhe trajnimet e tjera jashtë vendit kryesisht të ofruara nga ReSPA. Gjatë periudhës mars – dhjetor 2020, për shkak të pandemisë Covid-19, trajnimet janë realizuar online ku nëpunësit janë regjistruar në mënyrë individuale në **webinaret** që ASPA ka ofruar për tematika të ndryshme për të gjithë nëpunësit e MASR;
13. Raste të shkeljes së rregulloreve, kodit të etikës, rregullave të procedurave janë trajtuar në mënyrën e duhur konform akteve ligjore dhe nënligjore. Për periudhën në fjalë është zhvilluar vetëm 1 procedurë për shkelje disiplinore, rekomandim i KLSH;
14. Përfshirja e Sektorit të Burimeve Njerëzore në të gjitha takimet e zhvilluar nga DAP për rishikimin e përshkrimeve të punës për çdo pozicion sipas strukturës së MASR;

15. Organizim dhe bashkëpunimi për trajnimin e **200 oficerëve të sigurisë, punonjësve socialë/psikologëve** organizuar nga programi Suedez për policimin në komunitet në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme;
16. Ndjekja e procedurave për deklarimin para fillimit/ pas largimit nga funksioni dhe periodik për **42 punonjës të MASR** dhe institucioneve të varësisë;
17. Angazhimi për njoftimin/adresimin **dhe zgjidhjen për 250 raste për probleme të ndryshme** të dala gjatë periudhës së pandemisë;
18. Trajtimi i rreth **763 kërkesë/ankesave**
19. Mbledhja e të dhënave të dërguara nga ZVA/DRAPDPAP për planifikimin dhe rishpërndarjen e numrit të punonjësve për vitin e ri shkollor 2019-2020, si dhe 2020-2021, kontrolli i korrektësisë së informacionit në përputhje me aktet nënligjore në fuqi për numrin e mësuesve/ nxënësve për klasë, në institucionet e arsimit parauniversitar, për normat dhe ngarkesën mësimore në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.

II. VLERËSIMI I SISTEMIT TE MENAXHIMIT FINANCIAR DHE KONTROLLIT

Në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, kontrolli i brendshëm është një ndër preokupimet kryesore të menaxhimit të lartë që trajtohen me prioritet nga Titullari i Ministrisë, drejtuesit e programeve buxhetore, nëpunësit autorizues të nivelit të dytë dhe nëpunësit zbatueses duke synuar një mbështetje të gjerë të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Mbështetur në detyrimet e përcaktuara në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si edhe udhëzimet e dhëna nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave, titullarët e të gjitha njësive janë përgjegjës, për krijimin dhe monitorimin e kontrollit të brendshëm brenda strukturës që drejtojnë.

Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë **duke filluar nga viti 2017-2018** e në vijim, nisur nga performanca pozitive, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, **jemi autorizuar, për të punuar me të drejtat të plota drejtpërdrejt në modulën e Buxhetit në Sistemin informatike Financiar të Qeverisë (SIFQ)**, si Institucione Buxhetore të Nivelit të Parë, sipas hierarkisë me të drejtën e autoritetit për regjistrimin dhe aprovimin e transaksioneve lidhur me buxhetin, kontratatave, pagesave, rishpërndarjeve të buxhetit, si dhe hedhjes në sistem SIFQ të fondeve të miratuara për vitin ushtrimor si dhe për dy vitet pasardhës.

Parimi 3 – Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Titullari / NA i njësisë publike duhet të krijojë një strukturë organizative, të caktojë përgjegjësi dhe të delegojë përgjegjësitë përkatëse për të arritur objektivat e njësisë, duke mirë-përcaktuar gjithashtu edhe linjat e raportimit.

Në **zbatim të Vendimit nr. 505, datë 13.9.2017** të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë ”; është hartuar struktura e organikës Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe miratuar me **Urdhrin e Kryeministrit nr.163, datë 15.10.2017** të kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë", strukturë e cila është implementuar brenda 2017. Me **Urdhrin e Ministrit nr. 2457, datë 9.3.2017**, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore ekzistues mbi etikën, konfliktin e interesit, marrëdhëniet ndërmjet drejtuesve dhe të tretëve.

Në vitin 2019, me Urdhrin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i detyrave të hollësishme të organizimit, funksionimit të brendshëm dhe **marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit**. Kjo rregullore përcakton rregulla mbi koordinimin e funksioneve, administrimin e dokumentacionit, pajisjeve, orarit zyrtar, rregullat e etikës dhe procedura të tjera të menaxhimit. Në rregullore ekzistojnë gjithashtu përgjegjësitë dhe detyrat e çdo drejtorie e sektori si dhe marrëdhëniet midis tyre, kanalet dhe mënyrat e komunikimit. Detyrat funksionale të çdo punonjësi janë përcaktuar në përshkrimet e punës, të cilat si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore dhe angazhimeve të reja ligjore që drejtoritë duhet të përmbushin në kuadër të funksionimit të tyre, kanë nevojë për rishikim të vazhdueshëm.

- Urdhër i përbashkët i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 54, datë 30.1.2019 "Për miratimin e formatit të publikimit të të dhënave të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë".
- Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 88, datë 18.2.2019 Për disa ndryshime në urdhrin nr. 41, datë 24.1.2019, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit".

Kryesisht mjedisi i kontrollit ndikohet nga struktura organizative e cila është rishikuar për Aparatin e Ministrinë së Arsimit dhe Sportit, si dhe institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, në mënyrë që nivelet hierarkike dhe ato të raportimit të jenë të qarta, me lidhje funksionale, si edhe çdo objektiv dhe detyrë të jetë e mbuluar plotësisht dhe pa dublime.

- Rishikimi i funksioneve, detyrave si dhe strukturave është miratuar me Vendim nr.99, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", për ristrukturimi i DAR/ZA-ve, si dhe Urdhër të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 234, datë 19.4.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar".
- Rishikimi i funksioneve, detyrave si dhe strukturave, Vendimin nr. 98, datë 27.2.2019 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)", për ristrukturimi Institutit të Zhvillimit të Arsimit (IZHA) dhe Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA), si dhe miratimi i me **Urdhër nr. 69, datë 19.4.2019 të Kryeministrit** "Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)".

Në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit dhe përfshin vendosjen e objektivave që sigurojnë përmbushjen e misionit të çdo njësie, etikën personale dhe profesionale, strukturën organizative, filozofinë dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Parimi 4 -Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave. Njësitë publike demonstron një angazhim për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje dhe në mbështetje të objektivave të njësisë.

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", procesi është drejtuar dhe koordinuar nga Grupi për Menaxhim Strategjik (GMS), i cili është ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr.78, datë 08.05.2006, "Për krijimin e grupeve ministrore të punës për Strategji, Buxhet dhe Integrim, GSBI", i ndryshuar, ku një rol të veçantë ka luajtur koordinatori i GMS (Nëpunësi Autorizues/Sekretari i Përgjithshëm), në çdo njësi të qeverisjes qendrore, si dhe me drejtuesit e Ekipeve të Menaxhimit të Programeve. Hartimi i projektbuxhetit për periudhën afatmesme 2021-2023, është realizuar në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit, nr. 183, datë 23.6.2014 "Për përgatitjen dhe hartimin e kombëtare për zhvillimi dhe integrim, 2014-2020", objektivave të parashikuara në Vendimin nr. 11, datë 11.1.2016 të Këshillit të Ministrave, Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022", Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin 2017-2022", Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, tavanet e miratuara me Vendimin nr. 577, datë 22.7.2020 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", si dhe Udhëzimin Plotësues, nr. 28, datë 10.7.2020 "Mbi përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023".

Mbi këtë bazë janë vendosur dhe treguesit e performancës të arritjeve për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, objektivat, prioritetet dhe treguesit e synuar të performancës për çdo objektiv, për periudhën 2020-2022, si dhe për periudhën 2021-2023, ky proces është drejtuar dhe organizuar edhe në institucionet e tjera të sistemit arsimor.

- **Urdhrin nr. 222, datë 12.04.2019 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë** "Për krijimin e grupit për menaxhim Strategjik (GMS) në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë (GMS)", është krijuar grupi i menaxhimit strategjik përfshin Ministrin si Kryetar, Zv/Ministrat, Sekretarin e Përgjithshëm, Sekretarin

Teknik, si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, IZHA, ISHA, Agjencia për Rininë, etj.

- **Urdhri nr. 222/1, datë 12.04.2019 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë** "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve buxhetore për hartimin e planit afatmesëm buxhetor për periudhën 2019-2021", si dhe anëtarë të tjerë të cilët janë Drejtorët e Drejtorive në MASR, si dhe drejtues të institucioneve arsimore nacionale ASCAL, AKKSHI, IZHA, ISHA, Agjencia për Rininë, etj.

Në përputhje me metodologjinë e hartimit dhe finalizimit të këtyre dokumenteve strategjike, MASR ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit sipas kalendarit të aktiviteteve të parashikuara për secilën strategji, dhe është në procesin final të miratimit të strategjive.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale. Njësia publike duhet të ketë personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësi në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe më konkretisht në ndjekjen e objektivave të njësisë.

Për të gjitha njësitë e varësisë të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Nëpunësi Autorizues/titullari është autorizuar nga **Nëpunësi Autorizues i nivelit të dytë**, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", janë përcaktuar Nëpunësit Autorizues si dhe Nëpunësit Zbatues **si dhe është njoftuar Njësia Qendrore e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financës.**

Në ushtrimin e përgjegjësi nga titullarët ka procedura për delegimin e kompetencave bazuar në Kodin e Procedurave Administrative dhe rregulloret e brendshme.

- Urdhri nr. 110, datë 11.5.2020, "Për një shtesë në urdhrin nr. 587, datë 20.12.2019, "Për delegimin e kompetencave", të ndryshuar.
- Urdhri nr. 158, datë 8.6.2020, "Për delegim kompetence".
- Urdhri nr. 159, datë 8.6.2020, "Për një ndryshim në urdhrin nr. 587, datë 20.12.2019, "Për delegimin e kompetencave".
- Urdhri nr.261., prot , datë 30.7.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, "Për delegim kompetencash", Z. Alqi Kushi, i delegohen kompetencat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik.
- Me shkresën nr. 14742/1, datë 17.08.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, **miratohet Nëpunësi Autorizues** për fondet e MASR. Me shkresën nr. 3344/1, datë 29.07.2020 të Departamentit të Administratës Publike Z. Oltjon Muzaka, lirohet nga detyra e Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë. Me shkresën. nr. 4080/3, datë 07.08.2020 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, Z. Oltjon Muzaka, mbyllet si përdorues Nëpunësi Autorizues për Sistemin Informatikë Financiare të Qeverisë SIFQ. Me shkresën. nr. 4080/4, datë 07.08.2020 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë, Z. Alqi Kushi, **miratohet si përdorues, Nëpunësi Autorizues për Sistemin Informatikë Financiare të Qeverisë SIFQ.** Me **Urdhrin nr. 261., prot , datë 30.7.2020** të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, "Për delegim kompetencash", Z. Alqi Kushi, i delegohen kompetencat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik.
- Urdhri nr.300.,prot 5366, datë 07.10.2020 të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Z. Alqi Kushi, i delegohen kompetencat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik, të përcaktuara në nenin 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 "Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", si dhe në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik".
- Me **Urdhrin nr. 299., prot, 5247 datë 01.10.2020** të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë "Ngarkim i përkohshëm në detyrë". Z. Alqi Kushi është emëruar në pozicionin e Sekretari i Përgjithshëm
- **Urdhri nr. 300.,prot 5366, datë 07.10.2020** të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, Z. Alqi Kushi, i delegohen kompetencat e Titullarit të Autoritetit Kontraktor të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në zbatim të ligjit të Prokurimit Publik, të përcaktuara në nenin 28, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015 "Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", si dhe në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik". **Urdhri nr. 261.,prot , datë 30.7.2020** të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, "Për delegim kompetencash", shfuqizohet.

Gjithashtu janë të miratuara përshkrimet e punës për çdo pozicion dhe kryhen vlerësimet vjetore të punës mbi arritjet individuale në punë. Për ngritjen e kapaciteteve të punonjësve realizohen trajnime të vazhdueshme nga MASR, në bashkëpunim me DAP, si dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Për vitin 2020, në vijim të situatës së pandemisë COVID -19, trajnimet e Planifikuara për periudhën Prill Dhjetor 2020, janë zhvilluar online.

B) MENAXHIMI I RISKUT

B.1 Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitetet, raportimet dhe pajtueshmërinë.

Vendosje e objektivave afatmesme, si dhe hartimi i kërkesave buxhetore për vitin 2019-2021, për realizimin e objektivave afatmesme, mbështetet në strategjinë e arsimit parauniversitar të miratuara me Vendimin nr.11 datë 11.01.2016 të KM "Për miratimin e strategjisë së arsimit parauniversitar", strategjinë për kërkimin shkencor miratuar me Vendimin nr. 710, datë 1.12.2017 Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022", si dhe në strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2013-2020. Treguesit e performancës të fondeve për arsimin, objektivat, prioritetet dhe treguesit e synuar të performancës për çdo objektiv, për periudhën 2019-2021 për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, mbështeten në situatën aktuale si dhe në synimet e përcaktuara në programin e Qeverisë si dhe strategjitë e cituara më lart. Deklarata e Misionit të MASR-it për vitin 2020, është hartuar në dokumentin e PBA 2021-2023, sipas standardeve të përcaktuara në Udhëzimit nr.7, datë 28.2.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm".

Raportet e auditimit të brendshëm mbi funksionimin e procesit të menaxhimit të riskut, ju dërgohen Titullarëve si dhe drejtorive përgjegjëse për aktivitetet apo që kujdesen dhe raportojnë për objektiva, produkte si dhe synimet e pritshme.

Për vitin 2020, në raportet e riskut të parashikuara për vitin 2020, si dhe regjistrat e riskut apo Strategjinë e parashikuar të Riskut për vitin 2020, askush nuk e kishte parashikuara situatën e pandemisë COVID -19. Ndaj për këtë periudhë është punuar në MASR, për të rishikuar programe dhe standarde mësimore, përdorim i burimeve njerëzore, mirë-menaxhimin e kapaciteteve infrastrukturore, janë rialokuara apo rishpërndarë burime financiare, me qëllim krijimin e kushteve për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, realizimin e Maturës shtetërore 2020, si dhe fillimin e vitit shkollor 2020-2021 apo dhe vitit akademik 2020-2021. Janë mbështetur institucionet arsimore me 1000 mësues shtesë, janë rishpërndarë 540 mësues për plotësimin e vendeve të punonjësve psiko-socialë si dhe mësues ndihmës mësimore. Janë zhvilluar trajnime online e me punonjës mësimorë dhe jo mësimorë për periudhën Prill-Dhjetor 2020, të parashikuara më parë. Janë shfrytëzuar për mësimdhënie platforma dhe programeve elektronike, si dhe televizioni kombëtar shqiptar, etj

Procedurat e brendshme dhe politikat për menaxhimin e riskut, nga Drejtoritë apo Institucione jepet informacion mbi risqet e mundshme, si dhe propozime për të vlerësuar dhe ulur kostot e risqeve (psh; procedurat e marrjes apo largimit nga puna, procedurat për prokurime publike, procedurat për lidhje e implementim kontrate të mallrave, shërbimeve dhe rritje së kapaciteteve.)

Monitorime si dhe raportime për fondet buxhetore, procedurat gjyqësore, detyrimet e mbartura apo detyrimet e krijuara rishtazi etj.

B.2 Parimi 7 - Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave.

Për vitin 2020, hartimi i Regjistratit të riskut dhe i strategjisë së minimizimit të riskut është hartuar nga të gjitha programet buxhetore dhe aktualisht kemi një regjistër përmbledhës të riskut dhe strategjisë së minimizimit të riskut sipas strukturës së rishikuar të programeve buxhetore, objektivave, produkteve, si dhe aktiviteteve, si të fondeve buxhetore të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit 2020.

Njësia publike MASR, ka krijuar mekanizmat e vlerësimit të riskut, duke përfshirë këtu, përcaktimin e koordinatorit të riskut, ngritjen e grupit të menaxhimit të riskut. Koordinatorit të Riskut është Nëpunësi Autorizues.

Mbështetur në objektivat dhe synimet strategjike për periudhën 2017-2020, objektivat e identifikuar në PBA 2020-2022, është hartuar Regjistri i Riskut, për çdo drejtori, si dhe shkalla e vetëvlerësimit të riskut sipas formularëve standard, duke marrë për referencë, modelet e realizuara në manualin për menaxhimin financiar, shembullin e regjistratit të riskut të përgatitur nga Ministria e Financave.

Për vitin 2020, në kuadër të implementimit të projektit "Implementimi i një Sistemi Modern të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Inspektimi Financiar Publik në Shqipëri", në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit gjatë

vitit 2020, është zhvilluar me tej produkti për përshkrimin e punës sipas drejtorive, plani i punës sipas drejtorive, harta e proceseve të punës, regjistri i riskut, shkalla e vetëvlerësimit të riskut sipas formularëve standard, gjurma e auditimi në procesin e hartimit të buxhetit afatmesëm, gjurma e auditimit të prokurimeve publike, gjurma e auditimit në menaxhimin e aktiveve, gjurma e auditimit në procesin e prokurimeve publike, planet e kontrollit të brendshëm, si dhe gjurma e proceseve të punës brenda drejtorive, sektorëve deri tek punonjësit për operacione të veçanta.

Për vitin 2020, hartimi i Regjistrit të riskut dhe i strategjisë së minimizimit të riskut është hartuar nga të gjitha programet buxhetore dhe aktualisht kemi një regjistër përmbledhës të riskut dhe strategjisë së minimizimit të riskut sipas strukturës së rishikuar të programeve buxhetore, objektive, produkteve, si dhe aktiviteteve, si të fondeve buxhetore të miratuara me ligjin vjetor të buxhetit 2020.

B.3 Parimi 8 - Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime.

Veprimtaritë e Kontrollit: Në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Sporti, ushtrohen një sërë rregullash dhe procedura veprimi që synojnë reduktimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave, të cilat kanë natyrë kontrolluese, parandaluese apo zbuluese. Gjatë aktiviteteve të ndryshme të punës kryhen kontrole të caktuara që kanë të bëjnë me ndarjen e detyrave. Për saktësimin e të dhënave të përfshira në një dokument, ushtrohet sistemi me të paktën tre nivele kontrolli për punonjës/firma të autorizuar.

Urdhër shpenzimet për kryerjen e pagesave autorizohet/ realizohen gjithmonë pas **kontrollit paraprak nga Sektori i Financës** të dokumentacionit shoqërues të urdhër-shpenzimit, **nënshkrimit/firmës të Nëpunësit Zbatues**, si dhe **nënshkrimit të Nëpunësi Autorizues**.

Drejtesit e Ekipeve të Programeve buxhetore "Planifikim Menaxhimi, 01110", "Arsimi Bazë, 09120", "Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm, 09230", "Arsimi i Lartë, 09450", "Fonde për Kërkim Fundamental dhe Ekselencë 09770", si dhe "Fondeve për Sportin dhe Rinisë, 08140", janë iniciues të hartimit të PBA-se faza e parë dhe e dytë për periudhën 2021-2023.

Ndërsa për autorizimi i shpenzimeve të programeve respektive kryhet nga drejtorja përkatëse dhe personat e autorizuar, **nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues si dhe nënshkrimit të Nëpunësi Autorizues**. Gjithashtu kryhen edhe aktivitete të kontrollit të cilat kanë të bëjnë me monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

B.4 Parimi 9 - Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Institucioni merr në konsideratë njësia ndikimet e mundshme të riorganizimit, shtimit të njësive të reja organizative dhe ose ndryshimet e menjëhershme të strukturave ekzistuese në sistemin e kontrollit të brendshëm. Në të gjitha rastet shqyrtohen risqet e mundshme nga ky ndryshim strukturor, së bashku me efektet financiare të cilat mund të sjellin risqe të pa planifikuara. Gjatë vitit 2020 është punuar për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për implementimin me sukses të reformës në arsimin.

Gjatë kësaj vitit 2020 në MASR është punuar me përkushtim për zhvillimin dhe imlementimin e reformës në arsim dhe për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të propozuara në planin e punës për "Marticën e akteve ligjore dhe nënligjore për vitin 2020";

Për vitin 2020, **në zbatim të** ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, janë propozuar dhe miratuar nga VKM, *(bashkëlidhur aneksi me aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara për vitin 2020)*

C) AKTIVITETE KONTROLLI.

C.1 Parimi 10 -Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli.

Proceset dhe aktivitetet e kontrollit në formën e hartave të proceseve të punës, manualeve të proceseve të punës dhe ose procedurave të brendshme për proceset e punës, janë listuar dhe dokumentuar duke adresuar proceset e njësive për përmbushjen e misionit dhe objektivave të saj. Referuar rregullores së miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 2457, datë 9.3.2017, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sporti", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Po, për rregullat apo akte ligjore të vecanta, organizohen takime, trajnime të veçanta. Rregullorja është **Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019**, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sporti", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.

<http://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2019/11/Rregullore-e-brendshme-2019.pdf>;

Informacioni dhe Komunikimi. Harta e proceseve të punës, manualët e proceseve të punës, procedurat dhe politikat e brendshme, evidenca të tjera për procese të përcaktuara që kërkojnë veprimtari kontrolli.

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të institucionit si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet sipas rregullores së brendshme të Ministrisë duke respektuar nivelin e hierarkisë, në mënyrë shkresore dhe elektronike.

C.2 Parimi 11 -Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë.

Kujdes të veçantë i kushtohet komunikimit të informacionit në formën dhe kohën e duhur në mënyrë që të përmbushen sa më mirë përgjegjësitë e punonjësve dhe drejtuesve. Të gjithë punonjësit e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë janë trajnuar për përdorim të sigurtë dhe të drejtë të komunikimeve elektronike zyrtare bazuar në rregulloret e hartuar nga AKSHI mbi përdorimin e postës elektronike në administratën publike dhe përdorimin e shërbimit të internetit në administratën publike.

MASR ka zbatuar të gjitha standardet TIK të hartuara nga AKSHI në lidhje me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të internetit të MASR dhe për ndërtimin e dhomës së serverave në ambientet e MASR, sipas kritereve të përcaktuara në **vendim nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, i ndryshuar**, si dhe Vendimin nr. 36, datë 24.1.2018, Vendimin nr. 448, datë 26.7.2018, Vendimin nr.495, datë 13.9.2017 “Për miratimin e rregullave të përfuturit të shërbimeve publike elektronike, përgjegjëse është Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, si dhe vendimin nr. 88, datë 14.2.2018 “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar.

Në rastet e shkeljes së afateve të caktuara janë marrë edhe njoftime për tërheqje vëmendje apo masë disiplinore nga eprorët direkt. Informacioni dhe komunikimi lidhen gjithashtu edhe me teknologjinë e informacionit dhe zbatimin e rregullave të tyre për gjenerimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e informacionit në MASR.

C.3 Parimi 12 -Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Referuar rregullores së miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 2457, datë 9.3.2017, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Po, për rregullat apo akte ligjore të veçanta, organizohen takime, trajnime të veçanta. Rregullorja është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Në MASR në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Informacionit (AKSHI), janë duke u zhvilluar programe nga Drejtoria e Teknologjisë Informacionit dhe Komunikimit, skema për back-up e database-ve dhe aplikacioneve të zhvilluara për Drejtorinë e Shërbimeve të Përgjithshme, Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, QSHA (ish-AKP), IZHA ISHA edhe Qendra e Shërbimeve të Rrjetit Telematik. Skemat back-up janë të testuara dhe të stimuluar në rast se sistemi do të ketë një pikë dështimi.

Përfundimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit (EMIS) në arsimin parauniversitar dhe atë universitar ka mundësuar rritjen e eficiencës dhe transparencës në menaxhimin akademik dhe financiar në gjithë sistemin, që nga niveli i shkollës deri tek ai qendror.

Përfundimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Informacionit, dokumentacionit, arkivave (EDMRS) në Aparatin e Ministrisë së Arsimit, ka mundësuar rritjen e eficiencës dhe transparencës në menaxhimin të sistemit të menaxhimit, kontrollit, nga niveli më i lartë i ndarjes së detyrave tek specialistët dhe nga specialistët, sipas niveleve të aprovimit deri tek titullarët.

C.4 Parimi 13 -Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor.

Raportet e brendshme dhe të jashtme lidhur me objektivat, aktivitete dhe produktet e realizuara. Raportime financiare dhe operacioneve mujore, tremujore, 4-mujore, progresive vjetore. Rregullat dhe procedurat e brendshme që lidhen me informacionin.

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, i ndryshuar, ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, Vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për

parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”.

Monitorimi kryhet nëpërmjet monitorimit dhe performancës financiare të shpenzimeve të buxhetit, analizave të zbatimit të buxhetit sipas standardeve të përcaktuara në **Udhëzimin nr.22, datë 17.11.2016** të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, është hartuar dhe raportuar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, për vitin 2019. Nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve për çdo program, si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MASR janë përgatitur raporte për çdo 4-mujor, në progresiv 8- mujor, dhe vjetor për vitin 2020.

C. 4 Parimi 13 -Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor.

Në MASR janë disa llojet raportimit periodik brenda njësisë që i dorëzohen menaxherëve, Memo Informuese për çështje të veçanta, informacione, raporte monitorimi, raporte inspekte, si dhe raporte auditimi të AB. Për monitorimin e proceseve dhe aktiviteteve përdoren një sërë procedurash nga titullarët, nëpunësit Autorizues dhe zbatues si dhe drejtuesit e tjerë të lartë. Në përgjithësi raportohet mbi realizimin e buxhetit, produkteve, treguesve apo indikatorëve të miratuar për e monitorimin strategjive dhe objektivave, si dhe standardeve të përcaktuara në PBA. Sistemi i raportimit manual dhe/ose elektronik në MASR , me email apo sistemi i ERDMS, jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të njësisë në tërësi dhe të njësive të vartësisë të saj, nëse ka dhe kundrejt njësisë qendrore. Procedurat e monitorimit mbështeten në standardet e përcaktuara me:

- Udhëzim nr. 9, datë 20.3.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar .
- Udhëzimin nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”,
- Vendimi Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 26.12.2018 "Për garantimin e transparencës në Institucionet publike të arsimit të lartë"
- Urdhër i Përbashkët nr. 54, datë 30.1.2019, i ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për miratimin e formatit të publikimit të të dhënave të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë".

Raportet e monitorimit të buxhetit publikohen në faqen zyrtare të ministrisë të linjës, të cilat shfaqen edhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për financat nëpërmjet lidhjes së vendosur me faqet zyrtare të ministrive. Raporte monitorimi, si dhe raporte apo plane pune të realizuara.

Raporte monitorimi, si dhe raporte apo plane pune të realizuara gjatë vitit 2020.

1. Shkresa nr. 1664, datë 28.02.2020 dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë "Dërgohet Deklarata e Cilësisë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm për vitin 2019".
2. Shkresa nr.1643/1, datë 02.03.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet raportim i Monitorimit për periudhën Janar-31 Dhjetor 2019”
3. Shkresa nr.2945, datë 30.05.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet raportim i Monitorimit për periudhën Janar-30 Prill 2020”
4. Shkresa nr.5202, datë 30.09.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Dërgohet raportim i Monitorimit për periudhën Janar-31 Gusht 2020”

[https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/;](https://arsimi.gov.al/buxheti-dhe-financat/)

Përveç monitorimit të vazhdueshëm titullari i MASR dhe **nëpunësi autorizues përdor edhe auditimin e brendshëm të njësisë**. Në MASR, Drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm raporton direkt tek titullari, për çdo rast të auditimit të kryer në njësitë shpenzuese. Auditimi i brendshëm përveç kontrollit, konsiston edhe në dhënien e këshillave apo rekomandime të cilat kanë për qëllim përmirësimin e punës së MAS drejt arritjes së objektivave.

C. 5 Parimi 14 -Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.

Sistemi i raportimit manual dhe/ose elektronik në MASR, me e-mail apo sistemi i ERDMS, jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave të njësisë në tërësi dhe të njësive të vartësisë të saj, nëse ka dhe kundrejt njësisë qendrore. Në MASR ekzistojnë procedura për të siguruar që menaxherët dhe personeli i

njesisë publike të informohen për vendimet, projektet / nismat e njësive të tjera/ njesisë qendrore, që mund të ndikojnë në përgjegjësitë dhe detyrat e tyre.

Për të gjitha projektet, ngrihen Grupe Punë për realizimin e akteve, projektvendimeve , rregulloreve apo nisma të një rëndësie të veçantë. të gjitha projekte dërgohen për mendim në formë elektronike apo të shoqëruara me MEMO zyrtare.

Për projektligje, projektvendime sipas procedurave zhvillohen dëgjesa publike me aktorët dhe faktorët e interesit, dërgohen për mendim në ministrinë e linjës, apo sipas rastit dhe tek Komisioneri për Diskriminimin si dhe entet fetare e deri në OJQ që mbrojnë interesat e fushës së arsimit.

Te gjitha aktet sa me lart botohen paraprakisht ne faqen e e-Akteve, pas miratimit ne faqen zyrtare te MASR sipas rubrikave përkatëse.

E. MONITORIMI

E.1 Parimi 16 - Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Referuar rregullores së miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 2457, datë 9.3.2017, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore. Po, për rregullat apo akte ligjore të veçanta, organizohen takime, trajnime te veçanta. Rregullorja është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore.

Monitorime të veçanta në lidhje me detyrimeve të mbartura dhe ato të krijuara rishtazi, realizimin e projekteve me financim të huaj, apo financim të brendshëm, realizimin shpenzimeve në valutë e të tjera raporte, realizohet sipas standardeve kohore të përcaktuara nga Ministri i financave, si dhe sa herë të lind nevoja apo Titullari kërkon nga drejtuesit e drejtorive dhe njësitet e varësisë të MASR informacion të detajuar.

Janë realizuar analiza dhe dërguar raporte dhe informacione për Titullarët dhe në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi për vitin 2018-2019, për çdo 3-mujor për vitin 2020, s dhe detyrimet akumuluar deri më 31 Dhjetor 2020, i detajuar me të dhëna lidhur me:

- a) Historikun e detyrimeve të prapambetura, problematikat e situatës, shkaqet dhe arsyet e pamundësisë së deritanishme për të shlyer këto detyrime, masat konkrete të marra deri tani në këtë drejtim;
- b) Detyrimet e krijuara rishtazi dhe të akumuluar deri në 31 Dhjetor 2020;
- c) Vlera e likuiduar e detyrimeve të prapambetura deri më 31 Dhjetor 2020;
- d) Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura për vitit 2020, si edhe për një periudhë afat-mesme.

Raporte monitorimi, si dhe raporte apo plane pune te realizuara gjatë vitit 2020.

Shkresa nr. 486/20, datë 01.03.2019 dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë "Dërgohet Deklarata e Cilësisë e Sistemit të Kontrollit të brendshëm për vitin 2019".

1. Shkresa nr.1643/1, datë 02.03.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Dërgohet raportim i Monitorimit për periudhën Janar-31 Dhjetor 2019"
2. Shkresa nr.2945, datë 30.05.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Dërgohet raportim i Monitorimit për periudhën Janar-30 Prill 2020"
3. Shkresa nr.5202, datë 30.09.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Dërgohet raportim i Monitorimit për periudhën Janar-31 Gusht 2020"

Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën janar 31 dhjetor 2020;

1. Shkresa nr.448/1, datë 23.01.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për vitin 2019"
2. Shkresa nr.2215/3, datë 10.04.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Janar- 31 Mars 2020"
1. Shkresa nr.2215/8, datë 29.04.2020 dërguar institucioneve arsimore "Tërheqje vëmendje mbi krijimin dhe mos shlyerjen e detyrimeve të prapambetura". Për mos raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Janar – 31 Mars 2020.
3. Shkresa nr.3567, datë 02.07.2020 dërguar institucioneve arsimore "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Prill- 30 Qershor 2020" dhe daljen e përgjegjësive ligjore.
4. Shkresa nr.3585/1, datë 07.07.2020, dërguar institucioneve arsimore "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Prill- 30 Qershor 2020".

5. Përgjigje shkresës nr.12294, datë 30.6.2020, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Prill- 30 Qershor 2020".
6. Shkresa nr.4844, datë 11.09.2020, dërguar institucioneve arsimore "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Janar - 31 Gusht 2020".
7. Shkresa nr.5446/32, datë 26.11.2020, dërguar institucioneve arsimore "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Janar – 30 Shtator 2020".
8. Shkresa e MASR dërguar në MFE nr. 534/1, datë 28.01.2020.
9. Shkresa nr.90/1, datë 11.02.2021, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë "Informacion mbi raportimin periodik të detyrimeve të prapambetura, të krijuara rishtazi për periudhën Janar -Dhjetor 2020".

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET E AUDITIMIT TE BRENDSHËM DHE TË JASHTËM DHE INSPEKTORIATIT SHTETËROR TË ARSIMIT.

Funksioni i Auditimit të Brendshëm, si veprimtari e pavarur ndihmon menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke vlerësuar në thellësi sistemet e menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, me qëllim që të përcaktojë nëse ato funksionojnë në mënyrë eficiente për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

Struktura dhe organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.186, datë 18.10.2013 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", e rishikuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 07.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së MASR". <http://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2019/11/Rregullore-e-brendshme-2019.pdf>;

Rregullorja është Miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.352, datë 17.6.2019, është miratuar "Rregullorja e Brendshme e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit", delegohen detyra sipas kërkesave ligjore;

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, gjatë vitit 2020, nuk i ka realizuar objektivat e parashikuara në planin vjetor të miratuar nga Ministri me nr. 8899/1 prot., datë 10.10.2019.

▪ *Analiza e misioneve të auditimit:*

Për vitin 2020, ishin planifikuar për t'u realizuar 17 auditime të kombinuara në 17 institucione.

Në fakt janë realizuar 6 auditime në 6 institucione, nga këto 5 auditime të planifikuara dhe 1 auditim i pa planifikuar, kjo me kërkesë të Ministrisë së Financës.

Mos realizimi ka ardhur nga situata e krijuar nga pandemia, si dhe struktura e NjAB ka funksionuar me 50%, sepse dy auditues kanë dale në pension dhe nuk janë zëvendësuar deri me datën 22.12.2020.

▪ *Përmbledhje ekzekutive lidhur me auditimin i realizuar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar*

Në zbatim të programit të angazhimit të auditimit nr.5851/1, datë 10.12.2020, miratuar nga Ministrit i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nga data 11.12.2020 deri me datë 18.12.2020, Drejtoria e Auditimit ka realizuar një auditim në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, me objekt "Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe analizimi i masave të mara për parandalimin, krijimin e detyrimeve financiare dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", për periudhën 01.01.2020 deri më 30.09.2020.

Nga auditimi është konstatuar:

- a) Për vlerësimin paraprak të lindjes së detyrimeve financiare të prapambetura dhe klasifikimin e tyre sipas standardeve të kontabilitetit publik dhe kohës së krijimit të detyrimeve për çdo kategori, është vepruar sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe udhëzimit plotësues nr.1, datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019", udhëzimit plotësues nr.2, datë 20.01.2020 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020".
- b) Dërgimi i faturave për pagesë në thesar gjatë periudhës 01.01.2019-31.08.2020, janë bërë respektim të afatit maksimal prej 30 ditësh.
- c) Kjo tregon një nivel të kënaqshëm të realizimit të këtij indikator.
- d) Nga analiza e detyrimeve të likuiduara për periudhën e vitit 2019, deri më 31 Gusht 2020, konstatohet se Aparati i MASR, ka realizuar pagesa për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në masën 11.269 mijë lekë dhe për njësi shpenzuese "të tjera", ku përfshihen njësitë arsimore vendore, institucionet publike të arsimit të lartë si dhe institucione të tjera varësie, të cilat kanë realizuar pagesa për likuidimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në shumën 16.672 mijë lekë.

- e) Detyrimet e krijuara rishtazi dhe të akumuluarra deri me 31 Gusht 2020, në masën më të madhe janë krijuar nga institucionet publike të arsimit të lartë, përkatësisht; gjendja e detyrimeve në fund të vitit 2019 nga IAL publike paraqitet në masën 212.2 milion lekë ose 41.5 % e detyrimeve totale të trashëguar në vitin 2020, të cilat në 8 mujorin 2020 arritën në masën 108.4 milion lekë ose një ulje në masën 50% të tyre.
- f) Nga IAL publike deri më 31.08.2020, vihet re një ulje e detyrimeve të prapambetura afro 2 herë më pak në krahasim me një vit më parë. Detyrimet e krijuara rishtazi nga IAL publike kanë ardhur pasi këto institucione kanë trashëguar detyrime nga viti 2018, apo kanë ndërmarrë në vitin 2019 deri Gusht 2020 angazhime financiare, për shpenzime të kontraktuara me fonde e veta (të ardhurat).
- g) Këto detyrime janë parashikuar të likuidohen me fonde të krijuara nga të ardhurat e pritshme të institucionit, duke mos ndikuar në fondet e buxhetit të shtetit.
- h) Likuidimin e detyrimeve nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për periudhën Janar 2014 deri më 31 Gusht 2020, shpenzimet e realizuara nga Aparati i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe njësitë shpenzuese në varësi të MASR, sipas programeve buxhetore është bërë në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, të Vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, të Udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të Ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, si dhe udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, i ndryshuar.
- i) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Prokurimeve, në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, udhëzimit plotësues nr.2, datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, në fillim të vitit 2019 dhe vitit 2020, ka dërguar në Agjencinë e Prokurimit Publik regjistrin e realizimit të prokurimit publik për vitin 2019 dhe vitin 2020, duke njoftuar dhe degën e thesarit Tiranë.
- j) Disponibiliteti i fondeve buxhetore është realizuar sipas kërkesave të udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit. Fondet për investime në arsimin për vitin 2019-2020-2021 janë çelur me shkresat e MFE nr. 22760/348, datë 04.03.2019 si dhe nr.24325/234 datë 21.02.2020, ku parashikohen vlerat e projekteve me cikël dy apo tre vjet, duke parashikuar, miratuar dhe hedhur në sistemin SIFQ shumat e miratuara për çdo projekt.
- k) Hartimi i Pasqyrave financiare përmbledhës për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për vitin 2019, janë realizuar në zbatim të kuadrit rregullator në këtë fushë, të gjitha pasqyrat financiare të institucioneve arsimore, janë të konfirmuara nga degët e Thesarit dhe janë të reregjistruar për deklarimet e tyre në Sistemin SIFQ.
- l) Plani i detajuar “Për detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluarra që nuk kanë mundur të likuidohen deri më 31 gusht 2020”, realizohet/ parashikohet për çdo institucion dhe bëhet pjesë e regjistrit të parashikimit të prokurimeve publike për çdo institucion për vitin 2020, në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, ligjit nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, vendimit nr.50, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, si dhe të udhëzimit nr. 5, datë 27.02.2014, të ministrit të Financave “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, Shtojca 3, *detyrimet e prapambetura të krijuara rishtazi dhe akumuluarra deri më 31 Dhjetor 2018, për Aparatin e MASR dhe institucionet e varësisë.*
- m) Për ecurinë e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar ka raportuar në mënyrë periodike. Raportimi i fundit për shlyerjen e detyrimeve gjatë vitit 2020, është bërë me Memon paraqitur Sekretarit të Përgjithshëm në datën 31.01.2020, “mbi raportimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2019”, dhe relacion datë 30.09.2020, sipas të cilave në mënyrë analitike është raportuar për krijimin, ecurinë e këtyre detyrimeve si nga aparati i MASR dhe nga njësitë shpenzuese të varësisë nga MASR.

Grupi auditit ka bërë vlerësimin e indikatorëve si më poshtë:

- Krijimi i detyrimeve të prapambetura;
- Mjedisi i kontrollit;
- Dërgimi në kohë i faturave për pagesë në degën e thesarit;
- Numri i urdhër shpenzimeve të refuzuara nga thesari;
- Dërgimi në kohë i kontratave në degën e thesarit;
- Saktësia dhe konsistenca e raportimit për zbatimin e buxhetit;
- Si dhe disa indikatorë të tjerë.

Duke i vlerësuar me më shumë se 25 pikë nga 30 të mundshme.

▪ **Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre:**

Më poshtë është paraqitur tabela e parashikimit të risqeve sipas sistemeve pasqyruar në planin e vitit 2020, mbi bazën e së cilës DA, ka vlerësuar dhe ka paraqitur edhe nivelin e riskut për sistemin arsimorë.

Planifikimi i angazhimeve të auditimeve është bërë mbi bazën e vlerësimit të riskut si më poshtë:

Nr	Identifikimi i Risqeve	Vlerësimi i Riskut		
		Mundësia e ndodhjes e lartë, e mesme, e ulët	Impakti i lartë, i mesëm, i ulët	Risku total i lartë, i mesëm, i ulët
1	Risqet për Sistemet e Proceseve Organizative			
	1.1 Risqet në Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore			
	<i>Funksionimi i portalit "Mësues për Shqipërinë"</i>	I lartë	I lartë	I lartë
	<i>Ndryshimi i stafëve drejtues në institucionet e arsimit lartë</i>	I lartë	I lartë	I lartë
	<i>Rekrutimi i punonjësve dhe niveli i kualifikimit</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<i>Mos plotësimi i strukturave organike në ZVA</i>	I lartë	I lartë	I lartë
	1.2 Risqet në Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit			
	<i>Struktura e programit buxhetor</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
2	Risqet për Sistemet e Pagesave			
	<i>Mos pasqyrimi në kohë dhe i sakte i ndryshimeve në sistemin e pagesave</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<i>Menaxhimi i funksionimit të sistemit të pagesave</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
3	Risqet për Sistemet e Prokurimeve			
	<i>Përlogaritje fondit limit</i>	I lartë	I lartë	I lartë
	<i>Përzgjedhja e ofertës me të mirë</i>	I lartë	I lartë	I lartë
	<i>Anulimi i procedurave të prokurimit</i>	I lartë	I lartë	I lartë
4	Risqet për Sistemet e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar			
	<i>Saktësimet në regjistrat e llogarive</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
	<i>Niveli i besueshmërisë në informacion</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm
5	Risqet e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit			
	<i>Profesionalizmi i stafit dhe niveli i kualifikimit</i>	I lartë	I lartë	I lartë
	<i>Saktësia në përpunimin e informacionit</i>	I lartë	I lartë	I lartë
6	Risqe të tjera lidhur me sisteme specifike sipas misionit dhe qëllimit të institucionit, (investimet publike, të ardhurat, etj)			
	<i>Menaxhimi në sistemin e bursave</i>	I mesëm	I mesëm	I mesëm

Gjatë auditimeve të realizuara për vitin 2020, janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e subjekteve publike. Qëllimi i auditimeve nuk është vetëm përcaktimi i dëmit të shkaktuar apo përgjegjësive, por mbi të gjitha përmirësimi dhe parandalimi i përsëritjes së shkeljeve. Gjatë ushtrimit të auditimit të brendshëm në të gjithë aktivitetin e njësive shpenzuese/organizatave, është përfshirë vlerësimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm, klasifikimi dhe mënyra e operimit të tij si dhe efektiviteti i kontrollit në përgjigje të risqeve brenda drejtimit të entitetit. Ky drejtim i auditimit është vlerësuar dhe është parë me përparësi, për vetë faktin se mosfunksionimi i kontrollit të brendshëm, ka sjellë për pasojë prezencën e risqeve dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave të subjekteve në përputhje me programimin. Në subjektet, tek të cilat auditimi i brendshëm ka identifikuar dhe përcaktuar risqet kryesore, është vënë në dijeni drejtuesi i subjektit për të marrë masat e nevojshme për frenimin dhe minimizimin e tij.

Subjekteve i janë dhënë rekomandime për hartimin apo përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe ndarjen e përgjegjësive, për të menaxhuar risqet me qëllim frenimin dhe minimizimin e tyre, për rishikimin dhe rishqyrtimin rregullisht të kontrolleve respektive.

Fushat dhe sistemet pranë të cilave është evidentuar risk, në subjektet e audituara, paraqiten:

- Sistemi i emërimeve të drejtuesve të institucioneve shkollore;
- Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore në ZVA (Mos plotësimi i strukturave organike)
- Sistemi mbi vlerësimin e riskut si dhe funksionimi i njësive shpenzuese në lidhje me hartimin e gjurmëve të auditit në të gjitha institucionet e audituara,

Subjektet gjatë zbatimit të rekomandimeve, po marrin të gjitha masat për përmirësimin e sistemeve.

▪ **Gjetjet kryesore sipas sistemeve:**

a. Gjetjet e parregullsive sipas fushave ose sistemeve viti 2020:

në numër:

NR	Subjekti i audituar	Sistemi i pagesave, të dietave dhe honorarëve	Të tjera, Të kuadrit administrativ	Gjithsej
a.	1	2	3	4=2+3
1	Drejtoria Financës MASR	-	-	-
2	ZVA Pukë	-	3	3
3	Instituti i nxënësve që nuk dëgjojnë	-	2	2
4	Instituti i nxënësve që nuk shikojnë	-	8	8
5	Universiteti Elbasan	-	-	-
6	ASA	2	4	6
	Totali	2	17	19

b. Gjetjet me dëm ekonomik viti 2020:

në 000 lekë:

NR	Subjektet :	Tatime taksa doganore	Paga, shpërblime, trajtime	Shuma gjithsej
a.	1	2	3	4=2+3
1	ASA	-	133.3	133.3
	Totali	-	133.3	133.3

▪ **Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm:**

Duke e vlerësuar si një detyrë kryesore të auditimit të brendshëm, është kryer vlerësimi i sistemi i kontrollit të brendshëm, të ngritur nga çdo subjekt të audituar.

Për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, audituesit janë përqendruar kryesisht në masat e kontrollit, të planeve të organizimit, të metodave dhe të procedurave për administrimin e mjeteve monetare e materiale që sigurojnë ndarjen e detyrave, verifikimin reciprok të punëve me qëllim parashikimin e tyre ose të paktën të zbulohen pa vonesë anomalitë, gabimet dhe parregullsitë e informacioneve kontabile dhe financiare, shpërdorimet dhe dëmtimet etj.

Auditimi i sistemit të kontrollit të brendshëm është bërë jo për një kohë të caktuar dhe për persona të caktuar, por është vlerësuar si një proces i pandërprerë dhe i vazhdueshëm gjatë gjithë veprimtarisë, ku marrin pjesë të gjithë punonjësit e subjektit të audituar.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u bë sipas këtyre komponentëve:

• **Për ambientin e kontrollit të brendshëm;**

Bazat ligjore dhe rregullat e vendosura për auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm janë të plota dhe garantojnë përmbushjen e objektivave. Kompetencat e kontrollit të brendshëm janë të identifikueshme dhe vlerësohen në të gjitha njësitet e audituara. Në bazën ligjore, janë të përcaktuara qartë kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit, kryesisht në përgjegjësinë personale në zbatimin e ligjit. Strukturat organizative të miratuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, në një sërë rastesh nuk kanë qenë të plotësuara, duke ndikuar shpesh edhe në ecurinë e punës. Rregullat e "Kodit të Etikës" dhe integritetit zbatohen nga personeli. Ndarja e detyrave dhe e kompetencave kanë siguruar që të mos ketë konflikt interesi ndërmjet posteve dhe të drejtës së ushtrimit të kontrollit të gjithsecilit. Janë bërë trajnime dhe ka ecuri zhvillimi të burimeve njerëzore në drejtim të kryerjes me profesionalizëm të detyrave.

• **Për vlerësimin e riskut;**

Një ndër kushtet themelore për rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit dhe për përcaktimin e procedurave përkatëse është kontrolli me përzgjedhje në bazë të riskut. Disa subjekte të audituara nuk kanë të propozuara profile risku ose numri i propozimeve ka qenë i ulët.

Masat e ndërmarra nuk kanë qenë të mjaftueshme për të adresuar riskun dhe pengesat në arritjen e objektivave.

• **Për kontrollin e aktivitetit operacional;**

Gjatë auditimeve është vlerësuar se nga ana e drejtuesve të subjekteve të audituar ka vend për përmirësime në drejtim të përcaktimit dhe zbatimit të drejtë të politikave dhe procedurave për të ndihmuar përmbushjen e sigurt dhe efektive të aktivitetit operacional për të garantuar arritjen e objektivave.

Asetet janë të mbrojtura fizikisht.

Vlerësojmë se përgjithësisht burimet janë përdorur dhe përdoren në mënyrë ekonomike dhe eficiente në procesin e realizimit të objektivave.

- **Për sistemin e informimit dhe të komunikimit;**

Nga auditimet e kryera vlerësojmë se përgjithësisht, komunikimi dhe raportimi janë në nivel të mirë dhe sigurojnë informacionin e duhur në kohë për të gjithë nivelet e drejtimit.

Funksionon një sistem evidencash raportesh e protokolle, të cilat e garantojnë këtë nivel të informimit dhe të komunikimit.

Sistemi i informacionit financiar dhe i drejtimit është në pajtim me synimin për të sjellë raportime të nevojshme për arritjen e detyrave.

Nëpunësit e kuptojnë rolin e tyre në sistemin e kontrollit të brendshëm, se veprimi i tyre individual reflekton tek puna e të tjerëve.

Raportimet dhe komunikimet përgjithësisht kanë qenë korrekte.

- **Për monitorimin;**

Konstatohet se sistemi i kontrollit të brendshëm, është i monitoruar për të vlerësuar zbatimin në kohë të detyrave dhe objektivave .

Subjektet e audituara kanë një sistem të monitorimit të përditshëm dhe në çdo kohë të të gjithë operacioneve të punës. Ekziston një ndarje dhe pavarësi për sa i përket kontrollit të brendshëm.

Përgjithësisht vlerësojmë se, funksionimi i kontrollit të brendshëm në sistemin arsimor jep siguri në realizimin e objektivave, duke shprehur rezerva për disa sisteme apo fusha si më poshtë:

- Sistemi i strukturave organike për punonjësit në ZVA-ve;
Në këtë rast sistemi i kontrollit të brendshëm nuk është i plotë për pasojë ka rezultuar se në disa ZVA, nuk është plotësuar struktura organike i cili përbën risk në realizimin e objektivave.
- Sistemet e kontrollit të brendshëm për administrimin e aktiveve;
Në këtë fushë ekzistojnë sisteme të kontrollit të brendshëm por në disa institucione nuk kanë gjetur zbatim, duke çuar në gjendje të larta mallra e materiale për jashtë përdorimit, stoqe dhe si konkluzion duke mos pasqyruar saktësisht gjendjen e aktiveve në këto institucione. Si rrjedhojë ka çuar dhe në mos regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme për disa ndërtesa në të cilat ushtrojnë aktivitetin këto institucione

- **Çështjet e dërguara për investigim:**

Gjatë vitit 2020, nuk kemi pasur çështje të dërguara për investigim.

EKOMANDIMET:

- **Rekomandimet e propozuara:**

Gjatë vitit 2020, janë dhënë 18 rekomandime nga këto:

a. *Rekomandime të karakterit organizativ, gjithsej 16 ;*

1. Të merren masa urgjente për mbylljen programeve të studimit për studentët që u ka kaluar afati i mbarimit të ciklit akademik. (ASA)
2. Të merren masa urgjente për sistemimin e materialeve që janë gjendje në godinën pranë 21 dhjetorit. (ASA)
3. Të merren masa urgjente për sistemimin e materialeve që janë gjendje në ish godinën në rrugën Kont Urani. (ASA)
4. Nga MASR të merren masa urgjente “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë. përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë në këtë institucion. (ASA)
5. Emërtesa “Edukator”, në strukturën organizative të “Institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë” duhet të ndryshohet dhe të bëhet “Mësues ndihmës” ashtu si e përcakton Ligji Nr. 69/2012, “Për Sistemin arsimor para universitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, pika 3. (INND)
6. Institucioni menjëherë duhet të krijojë mundësinë, për 10 punonjësit mësues (mësues dhe mësues ndihmës) të pa certifikuar, që të trajnohen dhe pajisen me certifikate sipas përcaktimeve ligjore.(INND)
7. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, t’i kërkoj ZVA-së Tirane, që të shprehet për miratimin e rregullores së brendshme të shkollës.
8. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, në bashkëpunim me MASR-në, të bëjnë të mundur prodhimin dhe shumëfishimin e teksteve në “braille”, shkrim të zmadhuar literal si dhe pajisjen me libra të nxënësve të verbër kudo ku ata mësojnë.

9. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, në bashkëpunim me MASR-në, të ndërmarrë hapat e duhur për rregullime normative lidhur me kriteret mbi bazën e të cilave caktohet numri gjithsej i punonjësve si dhe struktura analitike, për çdo pozicion pune.
10. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, në bashkëpunim me ZVA-në Tiranë dhe DRAP-në Durrës, të ndërmarrë hapat e duhur për plotësimin e kuotës 60% të stafit, nga komuniteti i personave që nuk shikojnë dhe që njohin gjuhën braille.
11. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, në bashkëpunim me MASR-në, të ndërmarrë hapat e duhur lidhur me caktimin e numrit të nxënësve për klasë, normat mësimore si dhe normat e grupit mësimor-edukativ.
12. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, në bashkëpunim me ZVA-në Tiranë dhe DRAP-në Durrës, të ndërmarrë hapat e duhur për emërimin definitiv të drejtuesit të Institucionit, sipas kërkesave të akteve në fuqi.
13. Drejtori i "Institutit të nxënësve që nuk shikojnë" të ndërmarrë hapat e duhur për emërimin definitiv të nëndrejtorit të Institutit i nxënësve që nuk shikojnë, sipas kërkesave të akteve në fuqi.
14. Te ndërmerren te gjitha procedurat ligjore për plotësimin e pozicioneve në strukturën e ZVA, të paplotësuara. (ZVA, Pukë)
15. Me kryerjen e inventarizimit të pasurisë së institucionit të bëhen procedurat ligjore për nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit të pajisjeve elektronike te amortizuara. (ZVA, Pukë)
16. Instituti i nxënësve që nuk shikojnë, të ndërmarrë hapat e duhur për të përcaktuar në mënyrë të qartë procedurat dhe kriteret e pranimit të nxënësve në këtë institucion.

b. Rekomandime për arkëtime, gjithsej 2;

1. Të nxirret urdhër zhdëmtimi, të kontabilizohet veprimi dhe të arkëtohet shuma e përfituar me tepër si dietë plus karburant.(ASA)
2. Për pagesën e dietave ne rastin e shërbimit në Kukës dhe paguar si në Prishtinë, të ribëhen llogaritjet dhe përfituesit të kthejnë diferencat. (ASA)

▪ Përgjigjja dhe reagimet e menaxhimit: Raporti vlerëson se:

- a) 14 rekomandime të dhëna në institucionet e arsimit parauniversitar, subjektet e audituara i kanë pranuar të gjitha rekomandimet dhe kanë treguar gadishmëri dhe seriozitet në realizimin e tyre, këto rekomandime janë në proces zbatimi mbrenda afatit të përcaktuar në plan-veprime.
- b) 4 rekomandime të lënë te ASA, nuk ka reagime sepse procedura e auditimit është ndërprerë nga Ministri (Z. Shahini) me anën e nje urdhri verbal.

Deri me 31 Dhjetor 2020, është raportuar nga subjektet e audituara se, janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vitin e mëparshëm (2029), ndërsa rekomandimet e lëna në vitin 2020 janë në proces zbatimi, brenda afatit të përcaktuar.

MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CILËSISË

Për të rritur cilësinë e auditimeve, në vitin 2020, është kryer në vazhdimësi rishikimi i punës së audituesve dhe vlerësimi i cilësisë së auditimit.

Të gjitha proceset e auditimit (planifikimi, procedura e auditimit, raportet paraprake, raportet finale, memorandumet, evadimi i materialeve etj), janë rishikuar sipas kërkesave të pikës 4.8 të Kapitullit IV dhe të pikës 8 të Kapitullit VIII, të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Rishikimi u cilësisë së punës kryhet nga përgjegjësi i grupit të auditimit, si dhe nga drejtuesi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm (sipas aneksit 7). Grupi i punës që merr pjesë në një mision auditimi, është vlerësuar vazhdimisht nga performanca, përvoja dhe kualifikimet e gjithsecilit. Përmirësimi i programit të angazhimit, ka qenë prioritet i vazhdueshëm i punës së auditit. Procesi i auditimit është mbikëqyrur rregullisht, duke respektuar programin e auditimit dhe trajtimin e problemeve që mund të lindin gjatë një programi angazhimi.

ANALIZA E KAPACITETEVE AUDITUESE

▪ Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NjAB;

Drejtorja e Auditimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, është ngritur në mbështetje neneve 3/a dhe 10 pika 1/a të ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Struktura e sajë aktuale është e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 163, datë 05.10.2017 në përbërje (4+1). Për mendimin tonë, nisur nga numri i madh i institucioneve të varësisë që ka MASR, kjo strukturë duhet të jetë më e madhe në numër. Theksojmë se struktura ka qenë e pa plotësuar me dy pozicione auditit deri më 22.12.2020, kjo ka ndikuar në mos realizimin e planit vjetor.

▪ **Kapacitetet audituese**

- Arsimi profesional i punonjësve është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore të auditimit.
- Punonjësit e NjAB, përmbushin kërkesat ligjore të punësimit.
- Stafit është i certifikuar si audit në sektorin publik dhe ka kryer gjatë viteve të punës edhe trajnime për AB.

▪ **Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve**

Për periudhën raportuese, punonjësit e stafit kanë ndjekur trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm, për AB në Sektorin Publik, të organizuar nga DH/AB pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë,

KONKLUZIONE

▪ **Konkluzione mbi problematikën e punës audituese:**

Drejtoria e Auditimit, ka zhvilluar veprimtarinë audituese bazuar në procedurat e auditimit të rregulluara në aktet në fuqi, si dhe në praktikën më të mira të fushës, me qëllim garantimin e një efience sa më të lartë.

Gjatë kësaj kohe, i është kushtuar vëmendje procesit të vlerësimit paraprak të riskut, theksojmë se në këtë drejtim ka vend për përmirësime. Misionet e auditimit janë realizuar sipas programeve të angazhimit të detajuar për çdo fushë apo sistem auditimi, në përputhje me objektivat që drejtimi dhe grupi i punës ka caktuar për secilin mision, si dhe në përputhje me specifikat e subjektit që është audituar, bazuar në shqyrtimet paraprake të sistemit të kontrollit të brendshëm të tij. Me ushtrimin e veprimtarisë audituese vlerësojmë se kemi dhënë siguri të arsyeshme Titullarit të institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në sistemin arsimor. **Kemi identifikuar qartësisht sistemet, të cilat sipas subjekteve të audituara, nuk ofrojnë siguri ose ofrojnë siguri të arsyeshme,** duke dhënë në çdo rast sipas gjetjeve edhe rekomandime, zbatimin e të cilave është vlerësuar se do të ketë impakt të ndjeshëm në evitimin e shkeljeve dhe në përmirësimin e parregullsive të konstatuara.

Drejtoria e Auditimit, ka dhënë rekomandime për:

- përmirësime të sistemeve të kontrollit të brendshëm në përgjithësi;
- arkëtime të konstatuara;
- përmirësim të sistemeve me karakter organizativ.

DAB, ka një rritje të treguesve të performancës, lidhur me gjetjet dhe dhënien e rekomandimeve efektive. Subjektet e audituara kanë reaguar pozitivisht dhe i janë përgjigjur rekomandimeve të auditimit për korrigjimin e parregullsive, të cilat kanë shërbyer për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe shtimin e vlerës së subjekteve të audituara.

▪ **Prioritetet për vitin e ardhshëm:**

Drejtoria e Auditimit pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, planifikon dhe ka në frekuencën e saj të auditimeve, të gjitha institucionet e varësisë të cilat nuk kanë krijuar NjAB. DA, synon që të aplikojë metodologjitë dhe teknikat më të mira bashkëkohore për të përmirësuar planifikimin për auditim, rritjen e kapaciteteve të skuadrës audituese për të arritur objektivat, duke synuar dhënien e sigurisë objektive Menaxhimit të Lartë, mbi saktësinë dhe besueshmërinë e raporteve të angazhimeve të auditimeve.

Drejtoria e Auditimit do të arrijë:

- Të orientojë veprimtarinë audituese nga vlerësimi i riskut dhe nga dobia për menaxhimin.*
- Të përmirësoj shërbimin e auditimit duke synuar profesionalizëm të lartë, objektivitet maksimal dhe standarde të larta etike.*
- Të hartojë programe specifike për të gjitha fushat që mbulon sistemi arsimor.*

Për këtë, janë përcaktuar këto prioritet kryesorë si:

- Përmirësimi i procesit të vlerësimit të riskut, mbi bazën e të cilit të hartohen programet e angazhimeve të auditimit;*
- Zgjerimi i aftësive për të kryer auditime mbi bazë risku dhe sistemi;*
- Dobishmëria me impakt konkret, në arritjen e objektivave të organizatës, nëpërmjet dhënies së rekomandimeve efektive për njësitë e audituara.*

Drejtoria e Auditimit, ka parashikuar pesë objektiva kryesore strategjike, si dhe veprimet konkrete për realizimin e tyre në terma afatshkurtër. Nëpërmjet tyre është synuar të arrihet të ketë një shërbim auditimi bashkëkohor, nëpërmjet përmirësimeve të metodologjisë së vlerësimit të risqeve, teknikave të auditimit dhe rishikimit të brendshëm të cilësisë së auditimeve, me qëllim rritjen e cilësisë së raportimit si më poshtë:

Objektivat strategjike

Veprimet për t'u ndërmarrë

Produkti

1- Realizimi i auditimeve të plota për të përcaktuar zonat me rrezik të lartë në sistemin arsimor.	Krijimi i një sistemi të evidentimit të risqeve të kategorizuara sipas rëndësisë për secilën subjekt që do të auditohet.	Regjistri i risqeve mbi bazën e të cilit do të realizohen auditimet Metodologji të vlerësimit të risqeve.
2- Përmirësimi i metodave dhe teknikave të auditimit, duke zbatuar ato bashkëkohore, dhe të orientuara nga metodat shkencore (ekonomike dhe statistike).	Rishikimi i metodave të auditimit që i përkasin specifikisht sistemit arsimor.	Përditësimi i metodologjisë specifike të sistemit arsimorë.
3- Hartimi i një skeme të matjes së efektivitetit të veprimtarisë audituese duke realizuar analizën kosto/përfitim, në terma konkrete sasiore.	Hartimi i kësaj skeme, në bashkëpunim edhe me DH/AB dhe struktura të tjera të AB.	Skemë me treguesit kryesorë të matshëm të performacës së DAB.
4- Përmirësimi i cilësisë së rekomandimeve, me synim implementimin 100 % të tyre nga njësitë e audituara.	Ky objektivi është prioritar dhe në fokus të punës së çdo audituesi.	Rekomandime cilësore dhe të dobishme për njësitë e audituara.
5- Rritja e kompetencës së stafit me programe të diferencuara të trajnimit bazuar mbi nevojat reale të stafit.	Pjesëmarrja në trajnime të organizuara	Staf më i kualifikuar profesionalisht, për të kryer auditime cilësore.

V. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR PËRMIRËSIMIN E KUADRIT LIGJOR DHE NËNLIGJOR MBI SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM.

1. Rishikimin e Vendimin nr.175, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar” i ndryshuar, ku përcaktohet se” ;

- **3.a) paga e grupit (kolona 2 e lidhjes nr. 1)**, që është paga për nivelin arsimor të kërkuar, vlera e së cilës përcaktohet sipas lidhjes nr. 2, “Paga për nivelin arsimor”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;
- **3.ç) shtesa e pozicionit, (kolona 5 e lidhjes nr. 1)** që është e përcaktuar për çdo vend pune, sipas emërtesës përkatëse të pozicionit të punës.

Në këtë vendim punonjësit mësimorë në emërtesën “Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare”, janë klasifikuar në tre pozicione pune duke krijuar paqartësi në klasifikimin e tyre për punën në institucione arsimore si dhe pagën mujore sipas pozicionit. “Punonjësit aktualë mësimorë/edukatorë të cilët zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve universitare “Bachelor”, ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe deri para datës 1 mars 2017, kanë përfituar pagën e grupit në masën 14 000 (katërmëdhjetë mijë) lekë, do të vazhdojnë të përfitojnë të njëjtën masë të pagës së grupit deri në momentin e ndryshimit të nivelit të diplomës, apo ndërprerjes së marrëdhënieve të punës me institucionin arsimor përkatës. Punonjësit mësimorë/edukatorë që fillojnë punë për herë të parë si punonjës mësimorë/edukatorë në arsimin parauniversitar pas datës 1 mars 2017, do të trajtohen me pagë grupi sipas përcaktimeve të lidhjes nr.2 të vendimit.”.Pra sa më sipër Vendimi nr. 175, datë 8.3.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar duhet rishikuar me përparësi.

2. Rishikimin/ shfuqizimin e Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar **lidhjes 9/1 të**. Si dhe **lidhja nr.9/2 “Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore**”, zëvendësohet me lidhjen nr.9/2, “Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, shtesa për kushte pune”, lidhja 9/2, diskriminon në pagë dhe në vlerësim punonjësit e DAR/ZA në menaxhim me edukim në fushën e drejtësisë, në fushën e ekonomisë, si dhe inxhinierë që janë punësuar dhe realizojnë menaxhimin në këto institucione. Ky vlerësim është tregues i vetëm që sot më shumë se 25% e vendeve/pozicioneve të punës në këto institucione janë vakante, po kështu rreth 25% e drejtuesve të tyre, Nëpunësve të Autorizuar janë të komanduar. Në mjaft raste kjo dukuri po vijon për periudha më shumë se një vit dhe ky proces ka **sjellë cilësi më të ulët në zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

3. Shfuqizimin e Udhëzimit nr. 16, datë 20.7.2011 të Ministrit të Financave i cili vjen në kundërshtim me Vendimin nr. 511, datë 24.10.2002 të Këshillit të Ministrave “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar me Vendimit nr. 463, datë 16.6.2011. Vendimi i cituar më lart nuk i jep të drejtën Ministrit të Financave të vendosë me udhëzime kritere shtesë që kufizojnë të drejtat që punonjësve dhe nëpunësve të administratës u janë miratuar me ligj. Ky udhëzim vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, si dhe të neneve 76-108 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Shfuqizimin e Vendimit nr. 395, datë 29.4.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, pasi vendimi tejkalon përgjegjësitë e ngarkuara me ligjin vjetor të buxhetit për Ministrinë e Arsimit.

Në kuadrin e zbatueshmërisë në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, për mënyrën e Analizës së Menaxhimit të Riskut si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, është e nevojshme të ketë më tepër kualifikime, trajnime e seminare për zbatimin e plotë të ligjit nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) apo dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financës për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve të institucioneve.

Me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efencës së punës, përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë institucionale për menaxhimin e fondeve publike të njësisë, duhet siguruar që në këto trajnime të certifikohen, drejtues të programeve buxhetore, nëpunës autorizues/ drejtuesve të njësisve shpenzuese, nëpunës zbatues, si dhe një pjesëmarrje nga specialistë të tjerë, që ndjekin dhe raportojë tregues të arritjeve në arsim.

Aneksi nr. 1 Akte ligjore dhe nënligjore të realizuara/ miratuara në vitin 2020.

Nr	Titulli i aktit	Lloji i aktit
1.	Ligji nr. 105/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin””.	Ligji (i planifikuar në PPAP)
2.	VKM nr. 56, datë 29.1.2020, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Akademia e Shkencave tek Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), të objektit “Instituti Meteorologjik” dhe për një ndryshim në vendimin nr. 440, datë 16.6.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Akademisë së Shkencave”, të ndryshuar.	Vendim (i paplanifikuar në PPAP)
